

## PJESËMARRJA E MEDRESISTËVE NË DEMONSTRATAT E VITIT 1981

Trajtimi i ngjarjeve të mëdha politike që kanë ndodhur në një periudhë jo të largët të zhvillimeve historike dhe të përpjekjeve kombëtare shqiptare për çlirim nga pushtuesi sllavo-komunist, për çdo studiues është një proces hulumtues i mundimshëm dhe përgjegjësi e madhe intelektuale. Paraqitja e ngjarjeve të tilla dhe e zhvillimeve politike në trevat shqiptare, siç janë edhe demonstratat e vitit 1981, janë një obligim shtesë, kur dihet se një numër i madh i hulumtuesve shqiptarë dhe atyre ndërkombëtarë në fusha të ndryshme shkencore, historike, politike e juridike kanë ndriçuar periudhën në fjalë.

Megjithatë, nuk kemi hasur deri tani një hulumtim dhe trajtim të çështjes së pjesëmarrjes së medresistëve të medresesë “Alauddin” në Prishtinë, në demonstratat e vitit 1981. Një trajtim i këtillë hulumtues shkencor i ka munguar dhe i mungon historiografisë së trevave shqiptare, prandaj prezantimi i kësaj teme është i një rëndësie të madhe dhe plotësim i këtij boshllëku shkencor. Motivi për një punë të këtillë shkencore është i veçantë.

Synimi është që, duke analizuar dhe shqyrtuar me qasje kritike dhe të paanshme dokumentacionin e shumtë arkivor, materialin e bollshëm nga autorë vendës e të huaj, por edhe informacionet e shtypit të kohës, brenda hapësirës së ish-Jugosllavisë socialiste, dhe shtypit ndërkombëtar, të ofrojmë një dëshmi të rëndësishme për ato vite dhe ngjarje shumë të rëndësishme të historisë sonë të re kombëtare.

Demonstratat e vitit 1981 janë një kthesë e madhe në rrafshin politik kombëtar. Është fakt se në demonstratat e mars - prillit të vitit 1981, pjesëmarrjes masive të qytetarëve, studentëve, klasës punëtore, nxënësve të shkollave të mesme të Prishtinës, iu bashkuan edhe medresistët e medresesë “Alauddin”, për të drejtat themelore, ngritjen e nivelit kushtetues, nga autonomi në republikë, si fazë kalimtare, deri në shkëputje, me qëllim që

*“Kosova të ishte shtet i pavarur dhe sovran”<sup>1</sup>.*

Zhvillimi i përpjekjeve të popullit shqiptar në ish-Jugosllavinë socialiste, për realizimin e të drejtave themelore të statusit politik shtetformues, deri në aktin final: *“pavarësi dhe vetëvendosje, deri në shkëputje”* (Rezoluta e Bujanit)<sup>2</sup>, është proces i gjatë shekullor. Bashkimi i *“Shqipërisë etnike”*, ishte amaneti i shkruar dhe i përcjellë gjeneratë pas gjenerate, në vazhdimësi. Përpjekja e shqiptarëve për liri, përveç luftërave liridashëse dhe kuvendeve gjithëkombëtare me vendime historike përfshinte edhe protestat popullore, grevën e minatorëve në vitin 1989, demonstratat e fuqishme (1968 -1981-1989, 1997) si dhe demonstratën e vitit 1981 në Kosovë e diasporë.<sup>3</sup>

Këtij mozaiku të përpjekjeve gjithëpopullore, që nga themelimi i medresesë së mesme *“Alauddin”*, deri në luftën e fundit të vitit 1998-1999, i kanë dhënë një vlerë të veçantë dhe të pashlyeshme medresistët, me pjesëmarrjen e tyre, qoftë individuale apo në grupime, qoftë si nxënës, studentë apo në detyrën zyrtare të imamëve.

### **Pjesëmarrja e medresistëve në demonstratat e mars - prillit 1981**

Medreseja ka zhvilluar traditën e aktivitetit të saj edukativo-arsimor, fetar e kombëtar. Medreseja *“Alauddin”* ishte fidanishtja e trojeve shqiptare për edukimin fetar e kombëtar të brezave. Binomi për fe dhe atdhe në çdo situatë i ka bashkuar medresistët në të gjitha sfidat historike të përballjes me pushtuesin shekullor serb, që nga demonstratat e vitit 1968, 1981, 1989, 1997 e deri në vitin 1998-1999 të luftës çlirimtare, ku shumë medresistë dhe hoxhallarë ishin të angazhuar dhe të rreshtuar në formacionet ushtarake në çdo cep të Republikës së Kosovës. Madje një numër i tyre ranë shehid (dëshmor) në altarin e lirisë.

Demonstratat e vitit 1981 kanë qenë shembull i vazhdueshëm i përpjekjeve dhe unitetit shqiptar, si në kërkesa politike, ashtu

<sup>1</sup> Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, <https://www.kuvendikosoves.org/common>.

<sup>2</sup> Esat Kamberi, *Etnokulturocidi në Kosovë, Çabej, Tetovë, 1999.*

<sup>3</sup> Adem Ademi, *Jehona e demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, sipas shtypit serb (1981-1983), Temë e Masterit të mbrojtur në kolegjin “Dardania”, Prishtinë, 2012.*

edhe në përballje me forcat e policisë jugosllave. Medresistët e medresesë "Alauddin" të Prishtinës iu bashkëngjitën masës së gjerë popullore të prillit 1981, qysh në fillim të shpërthimit të demonstratave në kryeqytet.

Demonstratat e 11 marsit fillimisht ishin vlerësuar nga politika zyrtare, se kishin karakter ekonomik, por realisht ato ishin parapërgatitje për mobilizim masiv të 26 marsit 1981, ditë e cila tuboi rininë kosovare kundër politikës diskriminuese jugosllave. Rinia shqiptare u përball me dhunën e forcave të Policisë së Shtetit, që shkaktoi mjaft të lënduar, të rrahur brutalisht dhe disa të burgosur. Ngjarjet e mars-prillit 1981 dhe zhvillimet dramatike në kryeqytetin e Kosovës, medresistët i mbajnë mend shumë mirë në memorien e tyre.

*"Nga 11 marsi i vitit 1981, në Prishtinë vlonte diçka e madhe, por pakkush e dinte se çka po ndodhte apo se çka do të ndodhte. Megjithatë dikush e dinte, e dinin ata që ua ndiente zemra, e dinin se ia kishin bërë hyzmetin, që të ndodhte ajo që ndodhi".<sup>4</sup>*

Pasditen e 26 marsit 1981, zyrtarët e lartë politikë të Kosovës kishin organizuar ceremoninë e pritjes së rinisë pranë Teatrit Kombëtar të Kosovës, kurse rinia studentore kishte organizuar vazhdimin e demonstratave të 11 marsit. Ndoshta për shumë politikanë, intelektualë e qytetarë ka qenë befasi demonstrimi i rinisë kosovare ditën e pritjes së stafetës në Prishtinë, rast për të cilin mobilizoheshin të gjitha strukturat shoqërore e politike, për organizimin e manifestimit të pritjes dhe përcjelljes së stafetës, por kjo nuk ishte befasi për grupet ilegale dhe atdhetare.

*"Këto ngjarje nuk ishin veprim spontan, por ishin veprime me plan. - Kjo do të harrohet shumë shpejt! - më tha Ahmeti pasdreken e ditës së shtunë, të 28 marsit 1981, përpara gjimnazit "Sami Frashëri". Dhe ashtu ndodhi".<sup>5</sup>*

Periudha nga demonstratat e 26 marsit, deri më 1 prill 1981, karakterizohet nga përpjekjet e grupeve ilegale dhe grupeve studentore shqiptare, për sensibilizimin e popullatës shqiptare

---

<sup>4</sup> Prof. Dr. Feti Mehdiu, Kuntim bisedimor me autorin.

<sup>5</sup> Prof. Dr. Feti Mehdiu, po aty.

në çdo lagje të qyteteve, fshatrave e vendbanimeve të tjera në Kosovë. Përkundër masave të shumta shtypëse policore dhe shtimit të forcave ushtarake jugosllave, sidomos brutalitetit të njësisë speciale të Federatës Jugosllave ndaj djemve e vajzave shqiptare, përpjekjet e studentëve në realizimin e kërkesave të tyre nuk ishin ndërprerë, përkundrazi, ato ishin shtrirë edhe më tej. Përkrah masës së gjerë studentore, u rreshtuan edhe klasa punëtore, nxënësit e shkollave të mesme dhe shtresa të tjera, qytetare e fshatare.

Një përkrahje konkrete dhe e fuqishme, rinisë shqiptare dhe nxënësve të shkollave të mesme të Prishtinës, u erdhi nga bashkëmoshatarët e tyre të medresesë "Alauddin", që demonstruan rrugëve të Prishtinës, më 1 dhe 2 prill 1981. Ata ishin shumë aktivë dhe asnjë çast nuk ishin ndarë nga demonstruesit. Njëherësh, medresistët ishin një zë i fuqishëm kundër politikës shtypëse shtetërore sllavo-komuniste.

Në demonstratat gjithëpopullore të mars-prillit 1981 u përfshinë edhe ish-medresistët që studionin në Fakultetin Filologjik, në degën e orientalistikës. Ata ishin larguar nga hapësirat e fakultetit për t'iu bashkuar studentëve demonstrues, të motivuar nga profesori i gjuhës arabe, Prof. Dr. Feti Mehdiu, i cili iu ishte drejtuar studentëve të tij me fjalët: "Studentët dinë se çka dojnë dhe çka kërkojnë"<sup>6</sup>.

Ndërsa Prof. Meriman Braha, i dënuar politik, mësues i gjuhës shqipe në medrese, nga kujtimet e tij të 1 prillit 1981, sjell dëshmi konkrete të pjesëmarrjes së medresistëve, ku thotë:

*"Ditën e shpërthimit të demonstratave, shumica e nxënësve kishin dalë në oborrin e medresesë. Kishin mbetur pak nxënës dhe më pyetën: - Çka të bëjmë profesor? - Iu përgjigja: - O sot, o kurrë! Ata pak nxënës u nisën kah sheshi i Prishtinës, prej nga buçiste zëri i fuqishëm i rinisë shqiptare: "Kosova Republikë". Unë nxitoja për të motivuar nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike të Prishtinës, të cilëve ua kishin mbyllur dyert e shkollës, që mos të dilnin në demonstrata. Ishte zhurmë e*

<sup>6</sup> Prof. Dr. Isa Memishi, Bisedë ekskluzive për ngjarjet e vitit 1981. Memishi ka qenë medresist, kurse gjatë vitit 1981, ishte student i Fakultetit Filologjik, dega e Orientalistikës. Sot është profesor i gjuhës arabe në Fakultetin Filologjik të Prishtinës.

*rrëmujë në korridor dhe nëpër klasa. Fjala e parë që u kam thanë, ishte: - Çfarë pritni ma?! Nxënësit filluan të dilnin nga dritaret e klasave shpejt e shpejt, pak kush prej tyre mbeti në hapësirat e Shkollës Teknike”.*

Profesor Shaqir Zeneli që u kishte prirë nxënësve të shkollave të mesme në demonstratat e mars - prillit 1981, sqaron detaje shumë interesante nga zhvillimet nëpër lagjet dhe rrugët e Prishtinës:

*“Rinia e shkollave të mesme të Prishtinës, së bashku me medresistët e studentët, kanë qenë forcë e pathyeshme në ato ditë të vështira, në përballje me policinë dhe ushtrinë jugosllave, që përdorte lloj-lloj arsenali për të na shpërndarë. Nga dhuna barbare e njësisë së policisë federale, shpeshherë kemi qenë të detyruar të ndahemi dhe të zhvendosemi grupe-grupe, nëpër rrugë e lagje të Prishtinës, për të krijuar barrkada të reja, por asnjëherë të tërhiqeshim nga demonstratat dhe kërkesat legjitime. Medresistët kanë qenë stoikë gjatë tërë ditës, deri në orët e vona, nëpër rrugët e Prishtinës”<sup>7</sup>. Profesor Zeneli ishte prijës dhe organizues i rinisë në demonstratat e prillit, në lagjen e Tophanës.<sup>8</sup>*

Edhe në shtypin serb të kohës pranohet se demonstruesit shqiptarë ishin stoikë në kërkesat e tyre politike për statusin politiko-juridik: “Kosova Republikë”, kurse sulmet e milicisë jugosllave kishin qenë të ashpra dhe brutale ndaj rinisë kosovare, duke përdorur çdo mjet që zotëronin: autobлиндat, armët e zjarrit, lotsjellësit, shkopinjtë e gomës e deri tek aeroplanët, për t’i thyer ata. Përkundër përballjes disa herë me dhunën dhe terrorin e milicisë shtetërore, më 1 prill 1981, numri i të rrahurve, të plagosurve dhe të burgosurve shtoej, kurse motivimi dhe marshimi i demonstruesve shqiptarë nëpër rrugët e qytetit ishte i pathyeshëm, edhe pse forcat policore e ushtarake nga të gjitha viset e ish-Jugosllavisë hynin në Kosovë nga të katër anët, madje edhe nga aeroporti i Sllatinës.

Një korrespondent i shtypit ditor serb nga Prishtina, shprehu

<sup>7</sup> Shaqir Zeneli, Bisedë ekskluzive rreth zhvillimit të demonstratave të vitit 1981.

<sup>8</sup> Mustafë Lutolli, Bisedë ekskluzive për ngjarjet e demonstratave të vitit 1981.

opinionin e tij nga vendi i ngjarjes, duke parë me sytë e vet sulmet barbare të policisë jugosllave ndaj demonstruesve shqiptarë. Ai dëshmon se të nesërmen, më 2 prill, në rrugët e Prishtinës nuk kishte asnjë demonstrues shqiptar.

*“Edhe përkundër bindjes se të nesërmen nuk do të guxonte të paraqitej në demonstrata askush, mëngjesin e 2 prillit, në orën 06:00, grupi i punëtorëve të ndërmarrjes “Ramiz Sadiku”, të cilëve iu bashkëngjitën edhe punëtorët e kolektivit ndërtimor “Kosova” nga Vushtria, demonstruan rrugëve të qendrës së qytetit, bashkë me rininë kosovare të shkollave të mesme e studentore”<sup>9</sup>.*

Atmosferën dhe dëshminë nga ngjarjet e kohës i sjell Akademiku Fetih Mehdiu, i cili asokohe ishte profesor i Fakultetit Filozofik të Kosovës (sot Fakulteti Filologjik).

*“Pas datës 26 mars, arsimitarët e universitetit ishin bërë sy e veshë dhe gati u shndërruan në shërbim zjarrfikësish, për ta mbajtur nën kontroll zjarrin që vlonte në mesin e rinisë studentore. Në Fakultetin Filozofik kishim filluar të qëndronim tërë kohën me ndërtime, me orare kujdestarie. Kur dilnim nga fakulteti, zbatonim njëfarë rendi: dikush kthehej, dikush dilte, në mënyrë që në fakultet vazhdimisht të ishte dikush nga arsimitarët. Një prilli kaloi si kaloi në Prishtinë. Dy prilli gdhiu me një vello të zezë. Kah ora 10:00 erdhi Prof. Latif Berisha që udhëtonte nga Mitrovica dhe na tregoi se tek ura në Lakërishte ishin përqendruar forca të mëdha policore, ku kishin mbërritur edhe një numër i madh protestuesish, të rinj e të vjetër, nga anë të ndryshme të Kosovës, që kishin arritur të mësynin në Prishtinë. Atë ditë, pranë Fakultetit Filozofik nuk pamë të afrohej ndonjë masë e madhe populli, por dëgjohej dhe dihej se në Prishtinë acarimi i situatës kishte arritur kulmin.*

*Në Kosovë kishte hyrë ushtria me tanke. Avionët “Mig” që fluturonin mbi pullazet e shtëpive të Prishtinës, sa nuk ia morën kulmin Institutit Albanologjik. Atë ditë në Prishtinë ishte e tërë Kosova. Situatë e tendosur sa s’bën ndryshe...*

*Kjo ndodhi para tridhjetë e gjashtë vjetësh, kur nuk kishte*

<sup>9</sup> Adem Ademi, *Jehona e demonstratave të vitit 1981 në shtypin serb, 1981-’93.*

telefona celularë. Ne nuk kishim informata, se çka po bëhej në kryeqytetin e Kosovës. Edhe parandjenjat që kishim, nuk ia shfaqnim njëri-tjetrit për shumë arsye. Çdo gjë vlonte në vetvete. Këtë, vetëm ata që e kanë përjetuar, mund ta besojnë plotësisht. Të tjerët...?!

Kishte kaluar më shumë se gjysma e ditës, ndoshta tre të katërtat e asaj dite të enjte me pak re, mbi qiellin e Prishtinës, të përziera me tymin e lotsjellësit dhe erën e barutit që ishte zbrazur atë ditë.

Kolegëve u thashë se do të dilja për disa nevoja personale e do të kthehesha shpejt. Nëpër qytet nuk kishte turma populli. Aty-këtu ndonjë lëvizje e rrallë, jo në grupe, sepse ishte dhënë urdhri se nuk lejohej të lëvizje në grupe. Këtë kusht e plotësoja shkëlqyeshëm. Isha fillikat vetëm. Kalova para Radio Prishtinës dhe, kur dola te hotel "Grandi", hyra majtas rrugës, që të kaloja kah Sekretariati i Punëve të Brendshme të Kosovës. Kur arrita te Banka e Lublanës, hyra në një rrugë të ngushtë (sot rruga "Fazli Grajçevci") që shpie te shtëpia e mallrave, ish -"Gërmia", aty ku ishte hyrja për në vetëshërbim (sot aty ndodhet një ministri e rrethuar). Askush nuk lëvizte në atë drejtim.

Nja 10-15 metra përballë hyrjes së vetëshërbimit, ca njolla gjaku të mëdha ma vranë syrin. Ndërrova çehren (ngjyrën e fytyrës), ngadalësova hapin, por ecjen nuk e ndala. Nuk e dija se mu aty, pak më parë, kishin vënë themelet e shtetit të Kosovës me gjakun e tyre Naser Hajrizi dhe Asllan Pireva.

Nga ai moment, fillova të mendoja ndryshe. Kjo nuk është më demonstratë, thashë me vete dhe vazhdova rrugën. Dola në rrugën kryesore. Kalova sërish kah hotel "Grandi" dhe u ktheva në fakultet, ku në hyrje më prisnin disa nga profesorët me kureshtjen më të madhe. Të gjithë ishin më të moshuar se unë, ndër ta edhe profesori i gjuhës frënge, Gyltekin Shehu.

E vërejtën, sigurisht, shqetësimin tim, prandaj nuk më pyetën menjëherë se ç'kishte në qytet. Ipërshëndeta si e do rendi, por shumë rëndë. Isha nën trysninë e atyre njollave të gjakut që kisha parë në rrugë, përpara "Gërmisë", krahas rrokaqiellit të Bankës Ekonomike, tashmë Qeveria e Republikës së Kosovës.



*Në Prishtinë, sot është derdhur gjaku i studentëve, - u thashë me gjysmë zëri, shumë i prekur.*

*Për një moment, të gjithë u shtangën. Pas pak, mblodha veten, sa të thosha edhe këtë:*

*- Përpara "Gërmisë" dikush ishte vrarë, - pastaj heshta.*

*Askush nuk foli. Këtë heshtje të rëndë e prishi profesor Shehu. - Republikë është pak. Gjaku derdhet vetëm për shtet, - tha ai dhe përsëri ra një heshtje e rëndë.*

*Këto fjalë nuk i përsëritëm më për një kohë të gjatë. Aty u thanë dhe aty mbetën, por nuk u tretën.*

*Atë ditë, të enjten e 2 prillit 1981, Kosova nisi rrugëtimin për t'u bërë shtet. Rinia jonë e kishte ditur se shteti fitohej me gjak, kurse strukturat udhëheqëse të Kosovës, të ushqyer me iluzione, përpiqeshin të mbanin akoma gjallë "vëllazërimin e popujve të Jugosllavisë". Dikush këtë e kuptoi në vitin 1989 e dikush në vitin 1999. Mos e bëj Zot, që dikush akoma të jetojë me iluzione të ngjashme! Pranoje o Zot!"<sup>10</sup>*

Edhe pas demonstratave të pranverës së vitit 1981, medresistët ishin shumë aktivë, përveçse pjesëmarrës në përvjetorin e demonstratave të vitit 1982. Kur dilnin në qytet, ata mbanin në sakot e tyre simbolet e shqiponjës, në kokë mbanin plisin, dhe vishnin fanella të ndryshme kuq e zi. Aktivitetin dhe pjesëmarrjen e medresistëve në demonstratat e mëvonshme të Kosovës e gjejmë gjithashtu në demonstratat e marsit të vitit 1989, ku u vra nga policia serbe medresisti Mustafë Veseli, i cili ishte bashkë me shumë shokë të medresesë në demonstratë.

Përpjekjet e medresistëve për çlirimin e atdheut i ilustron edhe lufta e fundit çlirimtare (1998 - 1998) ndaj pushtuesit shekullor serb, kur dëshmorëve të atdheut iu shtuan edhe 37 emra të medresistëve shehidë, që vinin nga komuna të ndryshme të Kosovës.



## Diferencimi

Procesi i diferencimeve ideo-politike ishte vendim politik i LKJ-së, i dëmshëm dhe i njëanshëm ndaj shqiptarëve, proces i cili u realizua në çdo fshat e qytet të Kosovës. Diferencimet politike përfshinin të gjitha trevat e banuara nga shqiptarë, në tërë ish-Jugosllavinë, në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore. Ky proces ideopolitik nuk kurseu asnjë institucion politik, arsimor, kulturor, e shëndetësor. Pra, aksioni i diferencimeve preku çdo organizatë ku punonin e vepronin shqiptarët. Me një fjalë, diferencimi ideopolitik shtrihej në çdo pore të jetës shoqërore e politike, madje edhe ndaj vetë familjeve shqiptare.

Në veçanti, në mënyrë të pamëshirshme ishte goditur e luftuar

*“korpusi njerëzor shkencor i kulturës, arsimet dhe artit në trevat shqiptare të ish-Jugosllavisë, që kishin kaluar periudha të rënda dhe diskriminuese nga politika shoviniste serbe, sidomos periudha e Rankoviçit, etapa e LKJ-së (1981-1990)”<sup>11</sup>.*

Nga ky proces politik e pësoi edhe rinia kosovare, me vërejtje për përjashtime, përjashtime, humbje të së drejtës për shkollim, humbje të së drejtës për bursë, humbje të së drejtës për banim në konviktin studentor, madje edhe humbje e së drejtës për shkollim në fakultet etj.

Në fakultete nuk mundën të regjistroheshin 157 kandidatë (studentë), për shkak të papërshtatshmërisë ideopolitike. Gjatë vitit 1982-1983, 113 studentë nuk fituan të drejtën të vendoseshin në konvikte, 64 studentë u përjashtuan nga Qendra Studentore, 58 studentë u përjashtuan nga universiteti, pa të drejtë regjistrimi për një vit, 107 studentë morën vërejtje me shkrim dhe 54 studentë morën vërejtje.

Pas demonstratave të vitit 1981, tendenca për përjashtimin e nxënësve kishte edhe në medresenë e mesme “Alauddin” të Prishtinës. Rasti i parë i diferencimit në medrese rezultoi për shkak të një debati gjatë orës së mësimi, mes profesorit të gjuhës serbe dhe një nxënësi të medresesë. Ky rast ishte paraqitur te drejtori dhe rrethanat politike e kishin detyruar personelin arsimor të medresesë ta shqyrtonin këtë rast. Pas një debati të gjatë dhe konstruktiv, falë zgjuarsisë së personelit arsimor të medresesë

<sup>11</sup> Vepër e cituar.

dhe vlerësimit profesional, u shqua mendimi i profesor Meriman Brahos:

*“Profesori i gjuhës serbe nuk ka qenë në nivelin e duhur intelektual e profesional gjatë debatit me nxënësin dhe ka rënë në nivelin e duhur”.*

Ky mendim e lehtësoi debatin dhe kahjen e vendimit të personelit arsimor të medresesë.

Sipas dëshmimeve, rreth diferencimeve në medresenë “Alauddin”, profesor Rankoviçi ka qenë shkaktar edhe për mbledhjen urgjente të personelit kryesor të medresesë dhe prindërve të maturantëve, në pranverën e vitit 1982. Maturantët kishin lënë orën e mësimit dhe kishin dalë në manifestimin e përvjetorit të demonstratave në Prishtinë. Klasën e zbrazët e kishte hetuar profesor Rankoviçi dhe e kishte shtruar çështjen te drejtori i medresesë, z. Sherif Ahmeti. Trysnia dhe rrethanat politike e kishin detyruar stafin arsimor të thërriste prindërit e maturantëve. Në mbledhje, pos prindërve, kishin qenë të pranishëm edhe kujdestari i klasës IV, profesor Sadri Prestreshi; drejtori i medresesë, myderrizi Sherif Ahmeti; sekretari i medresesë, Resul Rexhepi dhe edukatori Imer Musolli. Pos temës së suksesit të nxënësve, u trajtua edhe disiplina, ku kujdestari i klasës, profesor Prestreshi, ndër të tjera, u tha prindërve:

*“Ne e dimë se ky është përvjetori i demonstratave dhe e dimë vullnetin e nxënësve dhe popullit, mirëpo kërkojmë nga ju prindër të bashkëpunoni me fëmijët tuaj në medrese, që të mos bëjnë vepra të hapura penale dhe mos të jenë shkak i rrezikimit të aktivitetit të medresesë”!<sup>12</sup>*

Kjo mbledhje kishte si synim që t’i bëhej me dije profesorit serb, se u morën masat e nevojshme ndaj maturantëve. Në fakt, debati nga kjo mbledhje dëshmoi se medresistët ishin pjesëmarrës në manifestimin e përvjetorit të demonstratave të vitit 1982. Duke u nisur nga një hulumtim i gjerë dhe voluminoz, mund të konsiderohet se medreseja e ka kaluar më së lehti procesin e rëndë të diferencimeve politike në të gjitha institucionet arsimore të trojeve shqiptare, sidomos të Kosovës.

---

<sup>12</sup> Mustafë Lutolli, Kumtim bisedimor me autorin.

## Burgosjet

Pas demonstratave të vitit 1981, ku pati rrahje, plagosje e vrasje, pushteti totalitar jugosllav vazhdoi procesin e ndjekjeve, persekutimeve, hetimeve të mundimshme dhe dënimeve drakonike të shqiptarëve. Faktikisht, nga medreseja ka pasur nxënës aktivë gjatë demonstratave të mars - prillit 1981, po kështu edhe në manifestimin e përvjetorit të vitit 1982, apo gjatë protestave të mëvonshme. Por, falë qëndresës burrërore të profesorëve, gjatë fazës së hetimeve nga organet e brendshme, medresistët kanë shpëtuar të pandëshkuar, njëherësh është ruajtur edhe institucioni i medresesë nga sulmet dhe penalizimet e mundshme politike të kohës.

Dëshminë e ruajtjes së sekretit për pjesëmarrjen e medresistëve në demonstrata e ka mbajtur burrërisht dhe fuqishëm profesor Shaqir Zeneli, gjatë procesit hetues. Ai ishte njëherësh edhe pjesëtar i grupit më të fortë ilegal, celulat e të cilit kanë vepruar fuqishëm kundër sistemit politik të kohës. Shaqir Zeneli, profesor i gjuhës shqipe në medresenë "Alauddin", me pseudonimin "Azemi"<sup>13</sup>, ishte pjesëtar i grupit "Fronti Popullor për Republikën e Kosovës" dhe i dënuar me 10 vite burg.<sup>14</sup>

Profesor Shaqiri në memorien e tij i ka të freskëta historitë dhe kujtimet e punës së tij në medrese dhe marrëdhëniet me stafin arsimor, për të cilët gëzon respekt të madh. Sigurisht që vlerëson dhe veçon ish - drejtorin e medresesë, myderrizin Sherif Ahmeti, i cili kishte qenë mjaft i kujdesshëm gjatë intervistës me hetuesit e inspektoratit krahinor, për vlerësimin e punës, profesionalizmin dhe sjelljet e dy profesorëve të gjuhës shqipe, Shaqir Zenelit dhe Meriman Brahës. Kurse dy profesorët e gjuhës shqipe, gjatë bisedës me hetuesit shtetëror, edhe pse hetoheshin për aktivitetin dhe dosjen e tyre politike e ilegale, përkundër dhunës e torturave, nuk kishin dhënë asnjë emër nga medreseja.

Pas arrestimit të profesor Zenelit nga policia, myderrizi Sherif Ahmeti kishte arritur t'i griste dhe t'i digjte në stufë fletoret e hartimit të gjuhës shqipe të maturantëve, pasi ata kishin realizuar

<sup>13</sup> Ethem Çeku, *Shekulli i legales. Brezi 81*, Prishtinë, 2004.

<sup>14</sup> Sabile Keçmezi-Basha, *Trajtimi i çështjes së Kosovës*, gazeta "Qëndresa Shqiptare" (VII), <http://www.zemrashqiptare.net>.

me profesor Shaqirin një hartim me temë nga pranvera e vitit 1981.<sup>15</sup>

Listës së të dënuarve politikë i shtohet edhe Meriman Braha, profesor i gjuhës shqipe në medrese gjatë vitit 1981, pjesëtar i grupeve ilegale, i cili ishte dënuar me 7 vjet burg.<sup>16</sup>

Shaqir Zeneli dhe Meriman Braha, gjatë vitit shkollor 1981, ishin profesorë të rregullt të gjuhës shqipe në shkollën e mesme teknike “28 Nëntori” të Prishtinës, dhe gjithashtu ishin edhe profesorë të gjuhës shqipe në medresenë “Alauddin”. Stafi i medresesë kishte hulumtuar një numër të konsideruar emrash të profesorëve nëpër shkollat e Prishtinës. Profesorët Zeneli dhe Braha ishin përzgjedhur në medrese, falë besueshmërisë që kishin krijuar përmes punës së tyre, te stafi arsimor dhe nxënësit në kryeqytetin e Kosovës. Përkundër moshës së tyre dhe viteve të kaluara nëpër burgjet e Jugosllavisë, ata të dy përkujtojnë me mall ditët që kanë kaluar me nxënësit e medresesë, të zellshëm në mësim e besim dhe shumë aktivë në demonstratat e vitit 1981.

### Disa statistika nga dënimet e grupeve ilegale

Demonstratat gjithëpopullore shqiptare në Kosovë, të mars-prillit 1981, ishin shkak i vendimeve politike të udhëheqjes së lartë ish-jugosllave, të koduara “RUBIN”. Me këtë dokument fillon agresiviteti institucional i Jugosllavisë ndaj popullatës shqiptare. Rrahjet, plagosjet dhe burgosjet masive i paraprijnë procesit të dënimeve. Procese gjyqësore zhvilloheshin në disa qytete të Kosovës, si në Gjykatën e Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës dhe Pejës. Po ashtu, sipas dokumenteve arkivore dhe shtypit të përditshëm serb, gjykimet ndaj shqiptarëve zhvilloheshin dhe shtriheshin edhe në shumë qytete të ish-Jugosllavisë socialiste, si në Beograd, Sarajevë, Zarë, Shkup e qytete të tjera.

Rina shqiptare, studentët, elita intelektuale e shumë ushtarë shqiptarë ishin objektiv i gjykrimeve nga politika ditore jugosllave. Gjykimet politike ndaj shqiptarëve, prej vitit 1981 deri në vitin 1998, kanë krijuar një histori më vete. Dënimet drakonike ndaj shqiptarëve kanë zgjuar interesimin e jashtëzakonshëm të shtypit,

<sup>15</sup> Prof. Zenel Shaqiri, Kumtim bisedimor me autorin.

<sup>16</sup> Portrete veprimtarësh, / rajonipress.com/

radio-televizioneve dhe agjencive më të njohura ndërkombëtare, nga të katër anët e botës. Masmédiat e interesuara ishin si nga blloku perëndimor, po ashtu edhe nga blloku lindor komunist. Masmédia ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e saj masive, kishte zbritur disa herë në Beograd e Prishtinë, për t'u njohur më nga afër me zyrtarët e lartë shtetërorë, zhvillimet, gjendjen dhe fatin e popullit shqiptar që përjetonte një periudhë më të rëndë se në kohën e Rankoviçit.

Gjykimet e rinisë shqiptare kishin arritur kulmin, për nga numri i madh i të dënuarve dhe vitet e marra nga gjykimet politike. Me këtë rast, për herë të parë kishin reaguar edhe studentët nga ish - Jugosllavia, duke u shkruar peticion institucioneve jugosllave, kundër dënimeve të mëtejme të rinisë shqiptare.

Grupimet politike shqiptare në diasporë, informacionet mbi gjykimet e shqiptarëve i kanë përkthyer dhe shpërndarë nëpër institucione të ndryshme ndërkombëtare, si OSBE, OKB me seli në Gjenevë, OKB në Nju (New) Jork dhe institucione të tjera. Po ashtu, rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacioneve mbi ngjarjet në Kosovë ka luajtur edhe shteti shqiptar, nëpërmjet radio-televizionit shqiptar, shtypit ditor dhe, në veçanti, nëpërmjet zyrave diplomatike në shumë vende të botës. Në bazë të statistikave të dhëna nga gjykatat mbi proceset gjyqësore që janë zhvilluar, dalin këto të dhëna për periudhën 1981-1988.

Deri në vitin 1981 (përmbledhje përfundimtare), pjesëmarrja për ndjekje të delikteve politike në Kosovë ka qenë rreth mesatares ose nën mesataren e Jugosllavisë. Nga viti 1982, numri i procedurave penale është ngritur papritmas dhe ka mbetur shumëfish më i lartë se mesatarja e Jugosllavisë, deri në vitin 1988.

**Shembull:** Shkalla e të dënuarve në Kosovë, gjatë vitit 1982, për vepra nga kapitulli XV i Kodit Penal të Jugosllavisë, është 3,448, në Jugosllavi 0,282 dhe në Serbi 0,057. Pra, shkalla e përqindjes së të dënuarve në Kosovë ka qenë 12 herë më e madhe se sa shkalla e përqindjes së Jugosllavisë dhe 60 herë më e madhe se ajo e Serbisë.

Shkalla për ndjekje të veprave penale, të kapitullit XV, nga Ligji Penal i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ) në Kosovë, është llogaritur në 10.000 banorë më të vjetër se 19 vjeç. Përqindja sillet nga 1, 26 (për persona të dënuar), deri në 1, 56 (për akuza të paraqitura), rreth tetë herë më e madhe se shkalla

gjegjëse për RSFJ-në dhe 90 herë më e madhe nga ato të Serbisë.<sup>17</sup>

Statistikat janë shumëfish më të mëdha, po të kemi parasysh shtrirjen e popullatës shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi, Kosovën Lindore dhe në republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Shënimet tregojnë se dënimet realizoheshin kryekëput ndaj shqiptarëve, për shkak të aktiviteteve të tyre politike e kombëtare.

### **Përfundime:**

Përpjekjeve të shumta të popullit shqiptar kundër pushtuesit shekullor sllavo-komunist i shtohen edhe demonstratat popullore të vitit 1981. Bashkërisht me zërin e rinisë shqiptare, edhe medresistët ishin pjesëmarrës aktivë dhe të zëshëm në këto demonstrata, si në çdo ngjarje të madhe historike të mëhershme dhe të mëvonshme, deri te lufta çlirimtare 1998-1999. Krahas mijëra nxënësve të shkollave të mesme të Prishtinës dhe rinisë kosovare, medresistët ishin pjesë e pandarë e barrikadave dhe e demonstratave të mars-prillit 1981. Pushteti jugosllav kishte angazhuar në Kosovë forca të shumta policore dhe ushtarake nga të gjitha republikat dhe krahina e Vojvodinës. Pushteti sllavo-komunist nuk ka kursyer asnjëherë metoda dhe mjete për të mbytur përpjekjet e popullit shqiptar. Edhe në demonstratat e vitit 1981, pos terrorit shtetëror, shteti serb realizoi procesin e stërzgatur të diferencimeve ideopolitike dhe burgosjeve drakonike, por nuk e ndaloj dot për asnjë çast idealin dhe rrugëtimin për çlirimin përfundimtar nga armiku shekullor serb. Procesi i diferencimeve në medrese nuk pati sukses, falë korrektësisë dhe kujdesit të stafit arsimor të medresesë “Alauddin”.

### **Bibliografia:**

- Ademi. Adem, *Jehona e demonstratave të vitit 1981, sipas shtypit serb (1981-1983)*.
- Kamberi. Esat, *Etnokulturocidi në Kosovë, “Çabej”, Tetovë, 1999.*

---

<sup>17</sup> Raporti i Komisionit të Pavarur - Kosovski Čvor: Dresiti ili seci, botim I, Geca Kon, Beograd, 1990.

- Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, <https://www.kuvendikosoves.org/common>
- Çeku. Et'hem, *Shekulli i legales. Brezi 81*, Prishtinë, 2004.
- Raporti i Komisionit të Pavarur - Kosovski Čvor: Dresiti ili seci, botim I, Geca Kon, Beograd, 1990.
- Basha. Sabile Keqmezi, *Trajtimi i çështjes së Kosovës*, gazeta "Qëndresa Shqiptare" (VII), <http://www.zemrashqiptare.net>
- Portrete veprimtarësh, /rajonipress.com/
- Biseda ekskluzive nga dëshmitarët e demonstratave të vitit 1981: Prof. Dr. Feti Mehdiu, medresist dhe profesor i Fakultetit Filologjik; Dr. Isa Memishi, medresist dhe profesor i Fakultetit Filologjik; Mustafë Lutolli, medresist; Zenel Shaqiri, profesor i gjuhës shqipe; Meriman Braha, profesor i gjuhës shqipe.